



Lista përfundimtare e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave, sipas nenit 10 të rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime)

NSh "Pasuria Bujqësore" (GJI011) Fi 650/89 në Ferizaj

Sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), 20% e të hyrave nga shitjet prej privatizimit dhe likuidimit të NSh-së së lartpërmendur do t'u shpërndahet punëtorëve të NSh-së të cilët i plotësojnë kushtet e parapara.

Në vijim është dhënë lista e personave të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të 20 % prej të hyrave nga shitja dhe përvoja e tyre e punës:

Mbiemri	Emri	Vite pune	Mbiemri	Emri	Vite pune	Mbiemri	Emri	Vite pune
Abdullahu	Ramiz	14,24	Hoxha	Bedrije	9,74	Mustafa	Hysen	34,76
Azemi	Haxha	28,78	Hyseni	Sabri	15,75	Mustafa	Ramush	15,83
Azemi	Nexhat	25,14	Ibishi	Rrahim	20,10	Nazifi	Halit	29,96
Cakolli	Naser	20,05	Ilazi	Sabri	23,06	Rama	Ramadan	18,14
Emini	Regjep	20,13	Islami	Shemshi	15,09	Ramadan	Idrizi	12,97
Emini	Safet	22,39	Januzi	Zenun	22,95	Reka	Isen	46,39
Esati	Isa	22,05	Konjufca	Fahrije	19,48	Rexhepi	Nuhi	26,55
Fazliu	Ramadan	28,89	Leka	Hasan	28,19	Rexhepi	Qerim	21,14
Ferizi	Zekir	28,19	Mahmuti	Islam	16,94	Rushiti	Muharrem	16,32
Gasi	Fadil	23,44	Maliqi	Xhavit	34,30	Sejdiu	Sejdi	20,64
Hajdari	Mehmet	16,00	Mjaku	Shaban	30,06	Sherifi	Xhemshir	28,94
Haliti	Besim	10,75	Muharremi	Rexhep	32,59	Skender	Isufi	16,80
Hamdush	Bajrami	39,66	Muharremi	Skender	23,98	Syla	Haki	24,23
Hasani	Mustafë	11,32	Muhaxheri	Hajriz	30,06	Sylejmani	Shkumbin	11,32
Haxhimusa	Avni	21,28	Murseli	Sokol	32,59	Tahiri	Fahri	28,89
Heta	Sami	28,49	Mustafa	Banush	20,03	Tusha	Islam	17,74
Xhaferi	Faik	20,18	Zeqiri	Azem	22,06	Zeneli	Xhavit	24,88

Sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), punëtori ka të drejtë të marrë një pjesë të 20 % të të hyrave nga shitja nëse ai/ajo ka qenë i evidentuar si punëtor i NSh-së së lartpërmendur në kohën e privatizimit ose likuidimit (cilado që ka ndodhë më parë) dhe që ka qenë në listën e pagave të NSh-së të paktën për tri vite. Punëtori i cili nuk e plotëson këtë kriter megjithatë mund të ketë të drejtë nëse diskualifikimi i tij/saj është bërë në bazë diskriminuese.

Secili person i cili mendon se ai/ajo do të duhej të jetë përfshirë në listë, që dëshiron ta kundërshtoj një ose më shumë emra në listë, ata të cilët mendojnë se stazhi i tyre i punës nuk është i saktë ose dëshirojnë të bëjnë ankese lidhur me mënyrën e shpërndarjes së fondeve sipas nenit 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), atëherë secili prej tyre mund të parashtrorjë ankesë në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës në pajtim me nenin 64.6 të Urdhërësës Administrative Nr. 2006/17 në lidhje me Rregullat e Procedurës së Odës së Veçantë. Ankesa duhet të behet me shkrim dhe duhet të përmbaj (1) emrin (emrat) e individit (individëve) në emër të të cilit është parashtruar ankesa (parashtruesi (parashtruesit e ankesave); (2) adresën e parashtruesit (parashtruesve) të ankesës dhe (3) arsyet e detajuara faktike dhe ligjore për parashtrimin e ankesës me dëshmi plotësuese (në rastet kur janë të aplikueshme), kurse kopjet e dokumenteve duhet të jenë të vërtetuara nga organi kompetent. Kur ankesa është parashtruar në emër të parashtruesit (parashtruesve) të ankesës nga pala e tretë (p.sh avokati), pala e tretë duhet ta siguroj autorizim me shkrim me të cilin vërtetohet se është i autorizuar për të vepruar në emër të parashtruesit (parashtruesve) të ankesës.

Ankesat duhet të parashtrohen në Odën e Veçantë në këtë adresë:

Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës
Rr. Nazim Gafurri nr. 31
10000 Prishtinë,
Kosovë

Të gjitha ankesat në lidhje me këtë njoftim duhet të dorëzohen deri më datën 12 nëntor 2011 para përfundimit të orarit të punës së të njëjtës ditë

Për informata shtesë lidhur me atë se si duhet të parashtrahet ankesa, ju rekomandojmë që ju apo avokati juaj të shikoj nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), Kaptinën e V të Urdhërësës Administrative Nr. 2006/17 ose të kontaktoni Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Sipas Nenit 24.6 të Ligjit Nr. 03/L-067 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, duke ju referuar Nenit 2 paragrafit 2 dhe 3, në lidhje me Nenin 113.1 të Ligjit Nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative, Sipas Nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13, Nenit 67.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6, Komisioni i Shqyrtimit pas shqyrtimit të padive në lidhje me mospërfshirjen e emrave të tyre në Listën e Përkohshme të punëtorëve të cilët do të përfitojnë një pjesë prej 20% të të ardhurave të privatizimit të NSH “Pasuria Bujqësore” – Ferizaj, më 20 korrik 2011 lëshon këtë:

SHËNIM MBI VENDIMIN

I Paditë e paditësve Ramush Karaliti, Rade Veljkovic , Gani Qamili, Emrush Mehmeti, Sami Kashtanjeva, Slobodan Djordjevic, Anton Mirdita, Nevenka Djordjevic, Slavica Petkovic, Zorica Sosevic, Leopasava (Lela) Aleksic, Feriz Ibishi, Bajram Abazi, Dobrila Trasic, Ljubo Djordevic, Milijana Trklja, Blagoje Konstantinovic, Dragica Janicijevic, Snezana Stanojevic, Zorica Stanisic-Susic, janë të **REFUZUARA SI TË PABAZUARA**

II. Padia e paditësit Stojan Parlic, është **REFUZUAR SI E PAPANUESHME**

Arsyetim

Lista e Punëtorëve e Komisionit të Shqyrtimit, bazuar në provën e vërtetuar të dorëzuar nga paditësit së bashku me padinë, ka ardhur në përfundim se paditësit në vijim nuk e përmbushin kriterin e pranueshmërisë për përfshirje në listë, sipas Nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13

A. Paditësit me provë të pamjaftueshme të vërtetuar

Paditësit Slobodan Djordjevic, Nevenka Djordjevic, Lepasava (Lela) Aleksic, Milijana Trklja, nuk kanë dorëzuar prova të mjaftueshme ligjore të vërtetuara në përkrahje të padive të tyre.

A.1. Paditësit Rade Veljkovic, Dobrila Trasic, Zorica Stanisic-Susic, kanë filluar punën e re me një punëdhënës tjetër.

A.2. Libri i Punës është i mbyllur

Paditësit Gani Qamili, Emrush Mehmeti, Sami Kashtanjeva, Anton Mirdita, kanë dorëzuar kopjet e Librit të Punës duke treguar se librat e tillë janë mbyllur dhe se paditësit nuk janë punësuar në NSH në kohën e privatizimit.

Sipas Nenit 69 të Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës, (“Gazeta Zyrtare e RS” no. 29/90, 42/90, 28/91) i cili konsiderohet të jetë Ligj i aplikueshëm në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/24 në lidhje me Legjislacionin e Aplikueshëm, Libri i Punës është një dokument publik i cili përmban të dhëna relevante në lidhje me fillimin dhe mbarimin e punësimit.

A.3. Padiësi ka dështuar të vërtetoj vazhdueshmërinë e punësimit të tij

Padiësit Slavica Petkovic, Zorica Sosevic , Ljubo Djordjevic , Blagoje Konstantinovic , Dragisa Janicijevic, Snezana Stanojevic, kanë dorëzua kopjet e vërtetuara të Librave të Punës të cilit ishin ende të hapura. Sidoqoftë, padiësit nuk kanë dorëzuar provë të mjaftueshme të vërtetuar bazuar në të cilat paneli mundi të vërtetoj që ata kanë ndërmarrë ndonjë hap pozitiv ligjor në mënyrë që ta ristabilizojnë punësimin pas qershorit 1999 ose ndonjë provë tjetër që tregon se padiësit ishin të interesuar të kontaktojnë menaxhmentin e NSH-së.

Padiësit kanë dorëzuar dokument(et) të cilat nuk ishin të vërtetuara në mënyrë të rregullt nga organi përkatës, sipas Neneve 1-4 të Ligjit për Vërtetimin e Nënshkrimeve, Dorëshkrimeve dhe Kumtesave ("Gazeta Zyrtare e RS" nr. 39/93, të datës 31.05.1993) dhe Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24.

Sipas Nenit 69 të Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës, ("Gazeta Zyrtare e RS" no. 29/90, 42/90, 28/91) i cili konsiderohet të jetë Ligj i aplikueshëm në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/24 në lidhje me Legjislacionin e Aplikueshëm, Libri i Punës është dokument publik i cili përmban të dhëna relevante në lidhje me fillimin dhe mbarimin e punësimit.

B. Padiësit të cilët kanë ndërruar jetë ose janë pensionuar para privatizimit

Padiësit Ramush Karaliti, Feriz Ibishi, Bajram Abazi, në periudhën e privatizimit ka qenë mbi moshën 65 vjeçare; sipas ligjit të aplikueshëm ka arritur moshën e pensionimit.

B.1 Padië e dorëzuara pas afatit të dorëzimit të padiëve

Padia e padiësit Stojan Parlic është refuzuar si e papranueshme sepse padiësit kanë dështuar të dorëzojnë padinë e tyre brenda 20 dite pas publikimit të Listës së Përkohshme, sipas Nenit 64.2 të UA të UNMIK-ut Nr. 2006/17.

Masa korrigjuese:

Pala e pakënaqur mund ta apeloj këtë Vendim në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës brenda 20 (njëzet) dite prej ditës së fundit të publikimit të listës përfundimtare të punëtorëve p.sh ky Vendim.

Komisioni i Shqyrtimit i Listës së Punëtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)